



VENDIM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË PANELIT

Data e miratimit: 7 mars 2017

Numri i lëndës: 2014-34

Rejhane Sadiku-Syla

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 7 mars 2017, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Elka ERMENKOVA, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Noora Aarnio, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi me 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. VENDIMET E PANELIT TË DATËS 19 TETOR 2016

1. Me 19 tetor 2016, Paneli ka marrë vendimin në lidhje me këtë lëndë, ku ka gjetur një shkelje të të drejtave të ankuesit dhe ka bërë rekomandimet e mëposhtme:

PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI,

1. *Vendos se ka pasur shkelje të neneve 2 dhe 3, dhe të nenit 13 në lidhje me nenin 2 të Konventës; dhe*

2. *Gjen* të përshtatshme, në bazë të gjetjeve të tij të mësipërme të fakteve dhe ligjit, që të bëjë rekomandimet e mëposhtme për shëfën e Misionit sipas Rregullës 34 të Rregullores së Punës:

- a. “ShM-ja duhet të bëjë një deklaratë që pranon se rrethanat e rastit kanë përbërë shkelje të të drejtave të ankueses, që i atribuohen veprimeve [dhe/ose mosveprimeve] të EULEX-it gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv.
- b. ShM-ja duhet t’i udhëzoj të gjitha organet e Misionit që janë në kontakt me viktimat e shkeljeve të pretenduara të të drejtave të njeriut të garantuara me nenet 2 dhe 3 të Konventës në kuadër të zhdukjeve të detyruara për të siguruar që në të gjitha komunikimet me ta, ata të komunikojnë me shpejtësinë, zellin e duhur dhe kujdesin e nevojshëm për të marrë parasysh shqetësimin emocional të bashkëbisedues(ve)it të tyre. Nëse është e nevojshme, ShM-ja duhet të konsideroj zbatimin e udhëzimeve të cilat përcaktojnë në mënyrë më të hollësishme se çfarë mund të nënkuptoj ky udhëzim i përgjithshëm në rrethana konkrete.
- c. Paneli është plotësisht i vetëdijshëm për sfidat dhe vështirësitë që rezultojnë nga reduktimi i burimeve të Misionit për shkak të rikonfigurimit, etj. Megjithatë, brenda kufijve të këtyre burimeve dhe në mënyrë proporcionale me rëndësinë që Misioni i jep mbrojtjes efektive të të drejtave të njeriut, Paneli fton ShM-në të siguroj që organet hetuese brenda Misionit të kenë në dispozicion të gjitha burimet e nevojshme dhe mbështetjen për të përmbushur misionin e tyre në mënyrë efektive dhe në përputhje me mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut të të gjithë të përfshirëve.
- d. ShM-ja duhet t’i udhëzoj organet hetimore të EULEX-it mbi rëndësinë e rasteve të zhdukjeve që vazhdojnë të jenë prioritet i hetimeve në mënyrë që ato të hetohen plotësisht dhe në mënyrë efektive dhe se kudo që të dyshuarit të identifikohen të sillen para drejtësisë menjëherë dhe në mënyrë të drejtë.

ShM-ja ftohet që autoriteteve kompetente hetuese dhe prokuroriale në kuadër të Misionit t’iu tërheq vëmendjen kah faktorët e cekur më sipër si relevante për kompetencat e “jashtëzakonshme” të prokurorëve të EULEX-it dhe për t’i njohur ata me rëndësinë e marrjes parasysh të këtyre faktorëve në vlerësimin e tyre nëse duhet apo jo që ata të kërkojnë të marrin përsipër përgjegjësinë mbi këtë lëndë.”

2. Kompetencat dhe autoriteti i Panelit për të përcjellë vendimet dhe rekomandimet e tij është dhënë në rregullën 45 e tutje të Rregullores së Punës (shih p.sh. vendimet për zbatimin e rekomandimeve *W kundër EULEX-it*, 2011-07, 26 gusht 2014; *Becić kundër EULEX-it*, 2013-03, 11 nëntor 2015).

II. INFORMATAT E MARRA NGA SHEFI I MISIONIT TË EULEX-IT LIDHUR ME ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË PANELIT

3. Me anë të letrës së datës 28 nëntor 2016, ShM-ja e ka dhënë përgjigjen e saj ndaj rekomandimeve të Panelit.

III. VLERËSIMI NGA PANELI

4. Në letrën e saj të datës 28 nëntor 2016, ShM-ja ndër të tjera ka thënë si në vijim:

“Një kopje e vendimit të Panelit i është ofruar prokurorëve të EULEX-it. Përveç kësaj, unë kam miratuar ngritjen e një Rrjeti Kontaktues për të Drejtat e Njeriut për të siguruar zbatueshmërinë e të drejtave të njeriut nga ana e divizioneve. Një shqyrtim i brendshëm i procedurave dhe udhëzimeve që janë tani në fuqi do të jenë pjesë e këtij procesi. Unë do të informoj Panelin lidhur me rezultatet e shqyrtimit të brendshëm.

Disa prej rekomandimeve të Panelit kanë të bëjnë me masat që janë nën kompetencë të Planifikimit Civil dhe Aftësive të Udhëheqjes (‘PCAU’), disa institucioneve të BE-së, si dhe Shteteve Anëtare. Kam informuar PCAU-në dhe Shtetet Kontribuese lidhur me vendimin dhe gjetjet e Panelit përmes Komandantit të Operacioneve Civile. Më tej, dëshiroj të theksoj se prokurorët e EULEX-it janë po ashtu njohës të rregullave dhe rregulloreve në fuqi sa i përket “rrethanave të jashtëzakonshme” të përcaktuara me nenin 7 (A) të Ligjit të ndryshuar mbi kompetencat”.

5. Së pari, lidhur me rekomandimin e parë (shih par. 1(a) më lartë), Paneli thekson me keqardhje se ajo ka qenë praktika e vazhdueshme e Misionit që të refuzoj apo që mos të pranoj zyrtarisht përgjegjësinë për shkeljen e të drejtave të njeriut të ankuesit, ku Paneli ka konstatuar se kjo kishte ndodhur. Një pranim i tillë do të ofrojë një formë të rëndësishme të dëmshpërblimit të drejtë në një rast si ky për të korrigjuar gabimet e bëra ndaj ankuesit nga ana e Misionit. Kjo formë e korrigjimit është edhe më e rëndësishme në kontekstin e tanishëm pasi që Paneli nuk lejohet të rekomandoj ndonjë lloj dëmshpërblimi monetar për të kompensuar dëmin që i është shkaktuar ankuesit.

6. Lidhur me rekomandimin se vendimi dhe gjetjet e Panelit duhet t'i dërgohen të gjitha organeve përkatëse (shih par. 1(b) më lartë), Paneli pranon se ShM-ja ka ndërmarrë hapa efektive për të zbatuar këtë rekomandim. Paneli është i inkurajuar edhe nga ShM-ja dhe e lavdëron atë për vendimin e saj për të krijuar një Rrjet Kontaktues për të Drejtat e Njeriut për të siguruar zbatueshmërinë e të drejtave të njeriut nga ana e divizioneve. Ky organizim duhet të ndihmoj që të bashkërendohen përpjekjet brenda misionit për të garantuar të drejtat e njeriut në kuadër të mandatit ekzekutiv të misionit dhe në këtë mënyrë të kontribuon në mbrojtjen efektive të këtyre të drejtave.
7. Paneli po ashtu kishte ftuar ShM-në të siguronte që organet hetimore në kuadër të Misionit të ketë në dispozicion të gjitha burimet e nevojshme dhe mbështetjen për të përmbushur misionin e tyre në mënyrë efektive dhe në mënyrë të vazhdueshme në mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut të të gjithë atyre që janë të përfshirë (shih par. 1(c) më lartë). Edhe pse ShM-ja nuk e ka trajtuar drejtpërdrejtë këtë rekomandim, Paneli është i bindur se me ushtrimin e vazhdueshëm të zellshëm të mandatit të saj, ShM-ja do të vazhdojë të siguroj se mbrojtje efektive të të drejtave të njeriut mbetet prioritet për të gjithë agjentët dhe organet e Misionit, duke përfshirë organet e saj hetimore.
8. Paneli gjithashtu kishte rekomanduar se ShM-ja duhet t'i udhëzoj organet hetimore të EULEX-it mbi rëndësinë e rasteve të zhdukjeve si prioritete hetimore (par. 1(d) më lartë). Përderisa ShM-ja nuk e ka trajtuar qartas këtë rekomandim, vendimi i Panelit ishte komunikuar në mënyrë të rregullt tek prokurorët e EULEX-it, kështu që Paneli pranon se me kohë dhe siç duhej shqetësimi i tij ka kaluar tek organet kompetente të Misionit.

PRANDAJ PANELI NJËZËRI

Deklaron se ShM-ja ka zbatuar rekomandimet e tij në këtë lëndë vetëm pjesërisht,

Mirëpret shenjën që është dhënë nga ShM-ja se ajo do të njoftoj Panelin lidhur me rezultatin e shqyrtimit të brendshëm që tashmë është duke u ndërmarrë dhe pret që të merr së shpejti këtë informacion,

Vendos të mbyllur shqyrtimin e kësaj lënde.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese